


## BASHKISË E TIRANËS DHE TË RINJTË SI KY GROUP SHOQËROR MUND TË KONTRIBUOJ NË KAPITUJT E KULTURËS DHE AMBJENTIT?

Sipas statistikave nga INSTAT, grupmosha 16-29 vjeç zë rreth 22% të shoqërisë shqiptare. Kjo grupmoshë është shumë e rëndësishme për shkak të lëvizshmërisë që siguron për shoqërinë. Rinia është një valvul e madhe që pompon vazhdimisht risi në makinerinë ku operon shoqëria. Si e tillë, ajo i siguron shoqërisë diçka jetike: ndryshimin. Rinia, për shkak të attributeve që përmban, arrin t'i prezantojë shoqërisë alternativa të reja, të cilat sfidojnë mënyrën e establishmuar të funksionimit të përditshmërisë..

Por fatkeqësisht, në Shqipëri, sipas një studimi nga KRK për vitin 2019, 84% e të rinjve në Shqipëri nuk janë aspak të interesuar për politikën. Vetëm 8% e tyre janë të angazhuar në ndonjë parti dhe pjesa tjetër janë të interesuar por jo të angazhuar. Mungesa e të rinjve në politikë krijon një vakum të madh. Angazhimi i tyre, përkundrazi, është antidoda ndaj disa prej problemeve të sistemit politik në Shqipëri. Integrimi në BE, jo thjesht si një proces administrativ, por dhe më gjerë, si një transformim rrënjësor i publikes në shoqëri, kërkon një angazhim të gjithanshëm të një gjenerate të re e cila nuk pranon t'i nënshtrohet modelit të vjetër të politik-bërjes.



Bashkia e Tiranës mund ta lehtësojë këtë angazhim sidomos në kapitujt e mjedisit dhe kulturës, dy hapësira ku të rinjtë e gjejnë veten më së shumti. Bashkia mund të krijojë Programin e Veprimit Mjedisor Rinor që angazhon aktivisht të rinjtë në trajtimin e çështjeve mjedisore lokale, në përputhje me kërkesat e acquis-it. Ky program mund të përfshijë të rinjtë në projekte praktike, si organizimi i punëtorive mjedisore në shkolla, ku të rinjtë mund të mësojnë për menaxhimin e mbetjeve, riciklimin dhe standardet e efikasitetit energjetik të BE-së, dhe të zhvillojnë ide se si Tirana mund të zbatojë këto politika. Bashkia mund të inkurajojë pjesëmarrjen duke ofruar bursa ose praktika për të rinjtë që tregojnë leadership në këto nisma.

Ndërsa në lidhje me kapitullin e kulturës, bashkia mund të prezantojë Programin e Ambasadorëve të Trashëgimisë Kulturore. Ky program do të përfshinte të rinjtë në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Tiranës. Pjesëmarrësit mund të udhëheqin ture kulturore për vendasit dhe turistët, duke theksuar historinë kulturore të Tiranës dhe rëndësinë e saj në kontekstin më të gjerë evropian.

Duke shfrytëzuar investimet në infrastrukturën digjitale, sidomos atë të Piramidës, bashkia mund të angazhojë të rinjtë në krijimin e përmbajtjeve digjitale si blogje, postime në rrjetet sociale dhe ture virtuale që promovojnë trashëgiminë kulturore të Tiranës, duke lidhur kulturën lokale me identitetet më të gjera evropiane. Programi mund të përfshijë partneritete me Ministrinë e Kulturës dhe muzetë lokale, duke ofruar të rinjve përvojë praktike në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe duke u dhënë atyre një platformë për të kontribuar aktivisht në acquis-in kulturor të Shqipërisë.

Duke zbatuar këto politika, Bashkia e Tiranës mund të përfshijë në mënyrë aktive të rinjtë në kapitujt e acquis-it, veçanërisht në fushat e mjedisit dhe kulturës. Këto nisma jo vetëm që do t'i edukojnë dhe fuqizojnë të rinjtë, por gjithashtu sigurojnë pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në formësimin e së ardhmes së Tiranës në përputhje me standardet e BE-së.

